



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediumet-

Shkup, 10.08.2022

Të dhëna jo të plota për mbështetjen e kthyer financiare nga shfrytëzuesit e masave qeveritare

Si rezultat i situatës së krijuar është zvogëlimi i të hyrave në Buxhetin e RMV-së në vlerë të përgjithshme prej 1.437.005 mijë denarë, gjegjësisht rreth 23 milionë euro

Revizorët konstatuan se institucionet e RMV-së **nuk kanë** të dhëna të plota për mbështetjen ekthyer financiare nga shfrytëzuesit brenda afateve dhe shumës së përcaktuar në buxhetin e RMV-së. Sipas analizës së revizorëve, punëdhënësit dhe personat fizik, shfrytëzues të masave për subvencionimin e kontributeve dhe pagesën e pagave, kanë kthyer **vetëm 29%** të detyrimit të llogaritur për kthim, gjë që ka efekt **më pak** mjete të kthyer në Buxhetin e RMV-së në shumën prej **988.307 mijë denarë**.

Gjithashtu, për faktin **se nuk ka** asnjë mënyrë për kontroll dhe kthim të mjeteve të ndara për mbështetje financiare të njëhershme për personat fizik dhe juridik nga aktivitetet e veçanta, **ekziston** rreziku që personat juridik që nuk i kanë plotësuar kushtet të mos i kthejnë mjetet në Buxhetin e RMV-së në vlerë prej **448.698 mijë denarë**.

Situatat e paraqitura kanë shkaktuar **zvogëlimin** e të hyrave buxhetore në vlerë të përgjithshme prej **1.437.005 mijë denarë**, përkatësisht rreth **23 milionë euro**.

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temë: **“Masat dhe politikat e marra në mbështetje të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga Covid-19”** në përputhje me Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021.


Qëllimi i revizionit të kryer është t'i përgjigjet pyetjes: **“A janë krijuar, realizuar, kontrolluar, monitoruar në mënyrë efikase masat e ndërmarra për mbështetje të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga Covid-19, si dhe a është siguruar informim adekuat për efektet nga**

masat e ndërmarra?" në drejtim të rritjes së efektivitetit të masave dhe politikave për përballimin me sukses të pandemisë Covid-19 dhe mbështetjes së vendeve të punës.

Me këtë revizion të suksesit janë përfshirë 36% nga totali i mjeteve të planifikuara për vitin 2020 dhe 2021 përmes programit të Qeverisë P – Masat për përballjen me krizën Covid-19, që **paraqet 12.637.534 mijë denarë (rreth 205 milionë euro)**, prej të cilave janë realizuar **11.512.447 mijë denarë**.

Kriza e shkaktuar nga përhapja e koronavirusit Covid-19 ka shkaktuar humbje të vendeve të punës në RMV dhe humbje të mëdha të të ardhurave të punëtorëve, gjë që ndikon në uljen e konsumit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas të dhënave të siguruar nga Agjencia e punësimit e RMV-së, nga fillimi i pandemisë deri më 31.12.2020, gjithsej **17.022 punëtorë kanë humbur punën**. Baza e pushimit është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr. 1 Ndërprerja e marrëdhënieve të punës në bazë të:



Duke theksuar rëndësinë e masave ekonomike të miratuara për të mbështetur punëdhënësit, individët e vetëpunësuar dhe profesionet, si dhe ndikimin e tyre në zbutjen e efekteve të pandemisë, me revizionin është marrë siguri e arsyeshme se krijimi i masave është kryer në mungesë të planifikim strategjik me objektiva të përcaktuar të qarta dhe tregues/indikatorë të performancës.

Mungesa e analizave dhe vlerësimeve të shkruara gjatë krijimit të masave për mbështetjen e punësimit në procesin e vendimmarrjes, dobësitë dhe të pa thënat e konstatuara në dekretet me fuqi ligjore dhe ligjet e miratuara që rregullojnë kushtet, mënyrën dhe procedurën e dhënies, ndikojnë në efikasitetin e zbatimit, monitorimit të zbatimit të masave dhe ruajtjes së vendeve të punës. Të dhënat jo të plota për numrin e

punëdhënësve që kanë përmbushur/nuk kanë përmbushur detyrimin për kthimin e mbështetjes financiare brenda afateve dhe shumës së përcaktuar në Buxhetin e RMV-së, kanë efekt në pakësimin e mjeteve të kthyera dhe realizimin e të ardhurave më të ulëta në buxhetin e RMV-së.

Me revizionin e kryer është konstatuar se ka një shkallë të lartë të realizimit të masave për mbështetje financiare për pagesën e pagave dhe mbështetjen e profesioneve, por edhe se ka dallime në të dhënat për numrin e përfituesve dhe fondet e miratuara/të paguara për përfituesit e paraqitur nga institucionet e ndryshme kompetente. **Mungon** mënyrë gjithëpërfshirëse, reciprokisht e harmonizuar dhe e integruar e mbajtjes së evidencave të mbështetjes financiare të miratuara dhe zbatuara në Qeverinë e RMV-së sipas masave, si dhe një **qasje jo konsistente** ndaj informacionit në lidhje me zbatimin e masave, gjë që redukton **transparentcën dhe llogaridhënien** e institucioneve kompetente në shpenzimin e mjeteve dhe nuk krijon kushte për matjen e efekteve të tyre.

Pas zbatimit të masave për mbështetje financiare të punëdhënësve për pagesën e pagave, DAP-i ka konstatuar se një numër i caktuar i punëdhënësve - përfitues të mbështetjes **nuk kanë paguar** pagat e punëtorëve të tyre. Numri i punëdhënësve që nuk kanë paguar pagat deri në janar 2022 është **135 për gjithsej 435 të punësuar** për shumën e përkrahjes së shfrytëzuar prej **6.317 mijë denarë**, që ka si pasojë keqpërdorimin e mbështetjes së ndarë.

Kontrollet jo në kohë dhe në numër të vogël, të kryera në terren prej 0,53% të shumës së akorduar të mbështetjes financiare, **mënyra e përzgjedhjes** së punëdhënësve për kontroll, si dhe **personeli i pamjaftueshëm** i institucioneve, krijojn **rrezik** që një pjesë e punëdhënësve të përdorin mjete financiare nga mbështetja financiare pa plotësuar kushtet e përcaktuara me dekrete dhe ligje.

Gjatë konvertimit të mbështetjes financiare si grant i pakthyeshëm, janë realizuar blerje për aktivitetet e zakonshme të biznesit të përdoruesit, të cilat nuk parashikohen si kusht për mbështetje të pakthyeshme, gjë që vjen për faktin se dekreti për mbështetjen financiare për pagesën e pagave nuk rregullon saktësisht se cilat blerje nuk do të njihen.

Në mungesë të analizave gjithëpërfshirëse për të matur efektet e masave në ruajtjen e vendeve të punës të mbështetura, ekziston rreziku i uljes së llogaridhënies, vlerësimit të suksesit të masave të mbështetjes financiare për pagesën e pagave dhe subvencionimit të kontributeve, si dhe mundësia e marrjes së masave për përmirësimin e kushteve të nevojës për krijimin e masave të reja në mbështetje të punësimit.

Mangësitë e konstatuara dhe efektet e arritura të masave për mbështetjen financiare të punësimit dhe profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga Covid-19, tregojnë se është e nevojshme të përmirësohet efikasiteti i institucioneve kompetente në planifikimin dhe zbatimin e masave të ardhshme për ruajtjen e vendeve të punës dhe reduktimin e pasojave ekonomike të pandemisë dhe atë:

- rregullim ligjor i gjendjes së jashtëzakonshme dhe miratimi i dokumenteve strategjike për trajtimin e pasojave në kushtet e pandemisë;
- planifikimi dhe realizimi i masave të bazohet në analiza të kryera dhe në tregues të përcaktuar për matjen e suksesit të masave;
- krijimi i një regjistri gjithëpërfshirës dhe të plotë të mbështetjes financiare të miratuar dhe të paguar veçanërisht për çdo masë dhe qasje e harmonizuar ndaj informacionit në lidhje me zbatimin e tyre;
- mbajtja e evidencës për mbështetjen e kthyer financiare për çdo përfitues dhe për çdo masë, si dhe marrja e masave për mbledhjen e mjeteve në bazë të vendimeve të lëshuara për kthimin e mbështetjes financiare në buxhetin e RMV-së;
- përfshirje më e madhe e kontroleve të zbatuara te përfituesit e mbështetjes financiare dhe matja e efekteve të masave të zbatuara.

Për përballimin e pasojave të krizës së shkaktuar nga virusi Covid-19, Qeveria e RMV-së ka miratuar gjashtë pako masash ekonomike në periudh prej 19.03.2020 deri më 20.04.2021. Me revizionin janë përfshirë planifikimi dhe zbatimi i gjashtë pakove të masave ekonomike të miratuara nga Qeveria e RMV-së në vitin 2020 dhe 2021 në pjesën e masave për mbështetje financiare për subvencionimin e kontributeve nga sigurimet sociale të detyrueshme, mbështetje financiare për punëdhënësit për pagesën e pagave, financiare, mbështetje për personat fizik të vetëpunësuar, kompensim monetar për të gjithë personat që kanë humbur vendin e punës nga data **11 mars deri më 30 prill 2020**, si dhe masa për mbështetjen e profesioneve të prekura nga kriza shëndetësore-ekonomike, siç janë mbështetje për sportistët, artistët e pavarur dhe punëtorët e kulturës.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk